

## LIGJËRIMI POLITIK DHE PUBLIK MBI INTEGRITETIN DHE DEKRIMINALIZIMIN

---

*Tetor – dhjetor 2021*

Ligjërimi mbi dekriminalizimin? Të gjithë akuzojnë të gjithë për korrupsion dhe lidhje me krimin. Politikanë përgjegjës nën hetim? Politikanë “non grata”? Parti me elementë e tipare korrupsioni apo inkriminimi? Standardet e karrierës politike dhe standardet e integritetit? A kanë reflektuar partitë tona politike mbi parimet e integritetit dhe të dekriminalizimit 6 vjet pas miratimit të ligjit që e bëri Shqipërinë vendin e vetëm në kontinent me koncept të dekriminalizimit në Kushtetutë dhe ligjet organike?

Për të pasur panoramë të plotë të gjendjes dhe ligjërimit politik e publik mbi këto tematika nuk mjafton vetëm analiza e qëndrimeve të partive politike dhe politikanëve të vecantë, por edhe monitorim i raportimeve në mediat kryesore, trendet e raportimit dhe vendi që zënë lajme të tilla në hirearkinë e lajmeve ditore politike.

Stafi i Instituti i Studimeve Politike (ISP) kreu monitorimin e ligjërimit politik të reflektuar në raportimet e medias gjatë peirudhës tetor-dhjetor 2021, si pjesë e projektit “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Monitorimi u shtri në të gjitha mediat kryesore televizive (TCH, Klan TV, Vizion Plus, Neës 24, Ora News, A2, Abcnews, etj), kryesisht në qëndrimet editoriale dhe në lajmet kryesore të ditës. Gjithashtu u monitoruan portalet kryesore, si dhe mediat e shkruara Panorama, Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Dita.

Synimi i monitorimit nuk ishte vetëm për të krijuar database me të dhëna, por edhe për të parë trendet e raportimit, tiparet kryesore të tyre dhe përputhshmëria e tyre me ligjërimit politik e publik të përdorur nga politikanët dhe drejtuesit e lartë të institucioneve, nga partitë politike dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë në Tiranë.

### GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT

---

- **Temat e dekriminalizimit, integritetit në politikë, politikanëve non grata dhe akuzave për lidhje të politikës me krimin apo të përfshirjes në korrupsion, kanë qenë temat dominuese të raportimeve mediatike mbi zhvillimet politike në peirudhën tetor-dhjetor 2021. Vendimi i SHBA lidhur me z. Berisha dhe ndikimet e vendimit të PD për pezullimin e tij nga**

grupi parlamentar, zhvillimet pasuese përfshirë debatet mbi demokracinë e brendshme dhe organizimet e takimeve publike të quajtur “foltore”, ishin kryetema e katër muajve të fundit.

- **Debati politik dhe ligjërimi publik mbi këtë rast dhe pasojat e tij në skenën politike treguan se ndonëse dekriminalizimi dhe integriteti në politikë kanë qenë kryetëm në 5-6 vitet e fundit, de facto partitë kishin evituar debatet reale dhe aplikimin e standardeve të dekriminalizimit dhe të integritetit në strukturat e tyre drejtuese. Kriza në PD tregoi se asnjëherë nuk ka pasur një qasje të qartë dhe reale me parimet e dekriminalizimit dhe se vetë kjo parti ka dështuar të aplikojë standarde meritokracie, transparence dhe llogaridhënie, pavarësisht deklarimeve afirmative publike.**
- **Debati tregoi gjithashtu se edhe partitë e tjera kryesore politike, përfshirë PS në qeveri dhe LSI në opozitë, më shumë e përdorin retorikën e dekriminalizimit dhe të integritetit në politikë në funksion të konsumit ditor politik sesa kanë një sistem apo qasje të ndryshme nga PD lidhur me këto çështje. PS nuk arriti të shmangë asnjë figurë të saj drejtuese të përfshirë në akte kriminale, nën hetim për korrupsion apo pjesë e listës amerikane “non grata”, ndërkohë që LSI iu kundërvu presionit perëndimor, duke e konsideruar cdo formë penaliteti si akt politik pro qeverisë.**
- **Zhvillimet e 4 muajve të fundit treguan gjithashtu se retorika mbi strukturat etike dhe të verifikimeve paraprake në partitë politike, - retorika e fushatës elektorale të PD për aplikimin e sistemit të primareve në përzgjedhjen e kandidatëve apo për aplikimin e sistemit të vetdeklarimit dhe konkurrimit në përzgjedhjen e kandidatëve në PS, ishte fiktive, e pabazuar dhe e mbështetur më shumë në motive propagande sesa të ekzistencës dhe funksionimit të tyre.**
- **Mediat i dhanë jehonë deklarimeve të palës amerikane dhe europiane lidhur me rëndësinë e dekriminalizimit të politikës dhe të qëndrimeve kritike ndaj personave të përfshirë në listat “non grata”, por nga ana tjetër, mediat u reshtuan në favor të qëndrimeve politike të palëve, pa arritur të krijojë një sistem presioni të së mirës dhe interesit publik ndaj partive politike, sjelljes, kandidatëve dhe krizave të brendshme të tyre. Mediat më shumë u vetshndërruan në shtojca të tribunave politike të palëve rivale në PD dhe më pas, palëve rivale në skenën politike, sesa informuan publikun dhe ndikuan në krijimin e një mjedisi dekurajues për politikanët e inkriminuar ose të korruptuar.**
- **Një gjetje tjetër e rëndësishme është se media dhe ligjërimi politik e publik morën të mirëqenë cdo raportim apo sinjal për të dhëna korruptive të ndonjë politikani, pa hyrë në verifikime paraprake të saktësisë të të dhënave, duke treguar se media e politika më shumë u kujdesën të “ushqejnë publikun” me akuza ndaj politikavëne të kundërt, sesa për të respektuar parimet etike të informimit dhe parimet etike të komunikimit politik dhe publik. Rasti “Hoti” ishte tipik, kur një deputete u vu në qendër të akuzave, raportimeve dhe sulmeve politike denigruese, sic rezultoi, pa pasur një bazë reale të dhënash faktike.**

- Një tipar tjetër i dukshëm i retorikës politike dhe publike, dhe bashkë me to, edhe i raportimeve mediatike, ishte tendenca e zyrtarëve përgjegjës në qeverisje për ta përdorur dekriminalizimin dhe nevojën e integritetit në politikë si mjet politik për të denigruar dhe atakuar rivalët politikë, gjë që në cdo rast krijon paqartësi në publik, sjell politizim të debatit dhe pamundëson shanset për një hetim serioz të fakteve, të dhënave dhe përgjegjësive të të akuzuarve apo të akuzuesve.

## **RASTET KRYESOR NË MEDIA DHE PJESË E LIGJËRIMIT POLITIK & PUBLIK**

---

Kjo pjesë e raportit përmbledhës të ligjërimit politik në lidhje me dekriminalizimin përmban një paraqitje të rasteve më të debatuar në raportimet mediatike dhe më të cituara edhe në ligjërimit politik e publik të vetë politikanëve dhe medias gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021. Të dhënat e raportit janë ndarë tre pjesë ku secila përkon me muajin e monitoruar. Duke nisur me muajin Tetor ku u panë disa trende, si më poshtë:

- Tema dominuese nga tetori në dhjetor ishin zhvillimet në PD dhe debati rreth shpalljes “non grata” të z. Berisha, ish kryeministër dhe deputet në parlament. Fillimisht vendimi për pezullimin e tij u përkrah nga i gjithë spektri kryesor politik, por më pas, PD hyri në një spirale debati e konfliktesh të brendshme që ndikuan në ndryshimin e qëndrimeve, nga kritika të moderuara në qëndrime të ashpra kundër Berishës dhe pro penalizimit të tij deri në përjashtim nga PD. Nga ana tjetër vetë Berisha kërkoi dhe promovoi të kundërtën, shkarkimin nga postet zyrtare të ekipit drejtues të PD. Dy palët përdorën retorikë aq të ashpër sa krijuan idenë se të gjithë janë ose mund të jenë objekt i dekriminalizimit, ndërkohë që po ashtu, dy palët akuzuan ashpër qeverinë dhe kryeministrin Rama për lidhje me krimin dhe korrupsion. Ky i fundit përfitoi nga rasti për të mbështetur nismën amerikane për personat “non grata”, si dhe duke përdorur një gjuhë gjithashtu akuzuese dhe denigruese ndaj rivalëve politikë.
- Më 1 tetor Ministri i Drejtësisë në fjalimin e tij në konferencën mbi “Rolin e Institucioneve Vetëqeverisëse Të Drejtësisë” vuri në pah angazhimin dhe vullnetin e mirë qeveritar mbi reformimin e sistemit të drejtësisë qoftë duke inkurajuar luftën ndaj pandëshkueshmërisë, apo duke reformuar administratën nëpërmjet krijimit të hartës së re gjyqësore dhe rritjes së kuotave në shkollën e magistraturës. Përdorimi i pandëshkueshmërisë në kontekstin e reformës në drejtësi, ndërkohë që opozita kishte iniciuar në shtator nismën për vettingun në politikë, përbën një dallim thelbësor midis palëve politike dhe një konstante në deklaratimet e secilës palë, PS dhe qeveria nga njëra anë dhe opozita nga ana tjetër.
- Më 9 tetor u njoftua akti i parë serioz i SPAK dhe sistemit të ri gjyqësor, dënimi i ish-prokurori i përgjithshëm Adriatik dhe shpallja e tij zyrtarisht në kërkim ndërkombëtar. Kjo ngjarje pati rëndësi pasi dolën në pah dy çështje kryesore, fillimisht bashkëpunimi i ngushtë ndër-institucional i SPAK me strukturat e tjera të drejtësisë dhe gjithashtu vendosmëria e tyre për t’i shkuar deri në fund rastit hetimor, pavarësisht postit dhe statusit të të akuzuarit.

- Rikthimi i nismës për vettingun në politikë nga opozita, përbën gjithashtu një zhvillim të rëndësishëm të kësaj periudhe. Kryetari i PD propozoi një proces vetingu që do të merrte në gjykim të gjithë deputetët e partive politike duke nisur nga vetë ai. Deklarata ka rëndësi specifike pasi vjen në kontekstin e zhvillimeve të reja politike në opozitë, por edhe ngritjen e debatit të vettingut në politikë në një nivel të lartë.
- Media raportoi denoncimin e një qyteti ndaj babait të deputetes Elda Hoti, duke e akuzuar atë për deklarim të rremë dhe shkelje të ligjit të dekriminalizimit. Kjo ngjarje theksoi problematikën e ngritur më parë, mbi dekriminalizimin në politikë, duke vënë në dukje një tjetër problem të drejtësisë, siç është ai i promovimit të fëmijëve apo të afërmeve të atyre personave që mund të kenë probleme me drejtësinë, pikërisht për të mbrojtur interesat e tyre. Një akuzë e tillë u përsërit disa herë ndaj ish deputetit Rakipi, i përfaqësuar në parlamentin e ri me dy familjarë të tij, pjesë e listës së deputetëve të PS-së. Në dy rastet si në rastet e tjera të ngjashme u shfaq dukshëm hezitimi nga Prokuroria dhe KQZ për të nisur hetimin pas akuzat e mundshme ose kryer hetime shteruese. Në dy rastet partia politike që i përket subjektit zgjodhi të mos jepte asnjë deklaratë mbi akuzat.
- Tetori u përmbyll me konfirmimin nga PS të gatishmërisë për zgjedhje të pjesshme në 6 bashki, përfshirë edhe ato ku zyrtarët e saj dhanë dorëheqje për shkak të dekriminalizimit ose të skandaleve korruptive. Ky qëndrim tregoi sa reflektimin e raporteve të reja politike midis PS dhe krizës në PD, ashtu, edhe vullnetin për të mos ushtruar presion mbi gjyqësorin në marrjen e një vendimi, i cili në rast pafajësie (rasti Lushnje) mund t'i rikthente sërish në detyrë.
- Më 1 nëntor PD përsërit akuzat e saj për Qerim Ismailajn, kryebashkiakun e Mallakastrës. Pas prokurorisë, ndryshimeve ligjore dhe ngritjes së SPAK, ky është zyrtari i parë i marrë në hetim. Ky i fundit pas ngritjes së akuzës nga PD nisi procedurat hetimore. Por fill pas veprimit të SPAK pati një reagim të fortë nga pala socialiste të cilët nëpërmjet deputetit Erjon Braçe shprehën indinjatën ndaj SPAK duke thënë se kjo strukturë po heton njerëzit e gabuar, ndërsa kriminelët e vërtetë po shpëtojnë. Kjo ngjarje shpreh brishtësinë e procesit hetimor të SPAK dhe ndërhyrjet që politika bën në të, sidomos kur akuzat e ngritura vijnë nga palë politike. Gjithashtu tregon edhe vështirësinë që ka politika shqiptare për të qëndruar larg çështjeve të gjyqësorit, sidomos kur bëhet fjalë për çështje që hetojnë zyrtarët e dalë nga gjiri i saj. Një tregues mjaft interesant është dhe mosreagimi i institucioneve zgjedhore për të referuar rastet, pasi çështjen e mësipërme Prokuroria e kishte dërguar në KQZ që në korrik, por kjo e fundit e kishte justifikuar me faktin që dënimi ishte thjesht një gjobë dhe për këtë arsye e kishte anashkaluar. Përveç kësaj shqetësues është rasti kur çështja në vend që të dërgohet në gjykatë për hetim, u kalua në KQZ, organ që i dha të drejtë kryebashkiakut.
- Për disa ditë deklarime publike e politike opozita risolli nevojën e një vetingu në politikë, por kjo deklaratë hasi në kundërshtimin e mazhorancës parlamentare, ku përfaqësuesit e tyre politikë u shprehën midis të tjerash se Shqipëria nuk ka nevojë për një proces vetingu të politikanëve, pasi i ka vetë të gjitha strukturat ekzistuese dhe kuadrin ligjor më se të aftë për ta kryer këtë gjë, pa patur nevojë për një proces të tillë. Këto zhvillime nuk u mirëpritën nga ana e opozitës si nismëtare e idesë së vetingut në politikë, ku Alfred Rushaj paraqiti zyrtarisht dy nismat për ndryshime në Kushtetuese, në të cilat prioritet numër një sipas tyre

ishite vetingu në politikë. Ky akt i opozitës tregoi përpjekjen e saj për të ndikuar në axhendën politike dhe për ta ndjekur në linjë institucionale dhe ligjore këtë nismë, krahas referimeve në SPAK të rasteve të evidentuara.

- Më 9 nëntor SPAK arrestoi disa zyrtarë të Tatimeve dhe Hipotekave në Durrës, të cilët kishin shpërdoruar detyrën. Ngjarja pati rëndësinë e saj specifike pasi tregoi vazhdimësinë e një procesi të nisur herët nga ana e tyre si edhe mbështetjen e qeverisë e cila e shikon këtë gjë jo vetëm si spastrim nga elementët abuzues por edhe si forcim i strukturave të saj. Disa prej këtyre zyrtarëve kishin luajtur rol elektoral në dy zgjedhjet e fundit, por partitë politike nuk u përfshinë në komente e kundër komente ndaj tyre.
- Më 1 dhjetor, ministri i drejtësisë, i cili luan rolin e koordinatorit kundër korrupsionit, raportoi disa raste shkeljesh, nga zyrtarë në institucione të ndryshme të vendit dhe inkurajoi hetim të thelluar dhe të pastër për ta. Denoncimet ndaj zyrtarëve të nivelit të mesëm dhe të poshtëm është bërë tashmë traditë, ndërkohë që nuk ka hetime për zyrtarët e lartë epror lidhur me përgjegjësitë në raste të tilla skandalesh korrupsione dhe as për sistemin e emërimit dhe promovimit të zyrtarëve të shkarkuar ose të arrestuar.
- Më 8 dhjetor SPAK bëri të ditur hetimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve pas një skandali të lidhur me konkursin për tu bërë pjesë e strukturave të saj. Kjo pati një specifikë interesante, megjithëse në denoncimin e kryer nga emisioni investigativ “Fiks Fare” rezultoi vetëm pak persona të përfshirë në skandal, SPAK nisi hetimin për një numër të madh zyrtarësh të DPB për të parë për raste të tjera abuzimesh. Ky është një rast sporadik suksesi por në një skandal pa peshë të madhe.
- Më 14 dhjetor pati dy raste, fillimisht SPAK nisi në Prokurorinë e Përgjithshme dosjen për ekstradimin e ish-prokurorit Adriatik Llalla në Shqipëri, ndërsa lajm kryesor u bë arrestimi i ish-ministrit Lefter Koka dhe disa funksionarëve të tjerë për skandalin e tenderit të inceneratorëve në Elbasan. SPAK pas arrestimeve fillestare shprehu se hetimi vazhdon për të tjerë persona të përfshirë.
- Më 15 dhjetor të gjithë palët politike mbështetën operacionin e SPAK në lidhje me skandalin e inceneratorëve, madje pala socialiste shprehu distancimin e saj dhe kërkoi hetim të pavarur të ish-ministrit Koka, si një tregues i qartë i përgjegjësisë personale që çdo politikan do fillojë të mbajë në vazhdimësi për problemet e tij me ligjin. Opozita e mbështeti rastin por në mënyrë të rezervuar, duke e konsideruar ministrin e arrestuar më shumë si viktimë dhe përpjekje për të shmangur nga hetimi dhe masa penale kryeministrin dhe kryetarin e bashkisë Tiranë. skandali në fakt u denoncua nga LSI, forcë politike në të cilën Koka kishte qenë themelues dhe ministër përpara se më 2019 të refuzonte dorëzimin e mandatit dhe vendosi të kalojë tek PS. Këto zhvillime dinamike nxorën në pah edhe disa indikatorë interesantë; fillimisht prania e disa strukturave paralele të cilat dekonspirojnë hetimet sekrete të një ndjeshmërie të veçantë kur bëhet fjalë për politikanë në hetim. Së dyti tregues kemi punën e vështirë të cilën SPAK kryen edhe pse me mbështetjen qeveritare në dukje, sërish merr presione indirekte. Ndërsa së treti, mjafton një operacion ndaj politikanëve në vend ku të gjitha palët e përfshira në të, inkurajohen të marrin pjesë dhe të sigurojnë informacione të mëtejshme duke qenë se marrin garancinë e një procesi të drejtë si në rastin e LSI që u dhanë informacione.

- Në dhjetor në dy ngjarjet e rëndësishme në PD, Kuvendi i datës 11 dhe më pas i datës 18, u përdorën retorika të ashpra akuzuese për rivalët politikë brenda PD, duke aluduar për lidhje me krimin, korrupsion dhe keqpërdorim të pozitës dhe mandatit politik në funksion të agjendave personale dhe familjare. Dy palët bënë premtime të shumta për reformimin e sistemit të zgjedhjeve, për jetësimin më cilësor të vetingut në politikë dhe të dekriminalizimit dhe për nxjerrjen përpara drejtësisë së politikanëve të korruptuar. Premtimet, ndonëse pozitive, duhen kuptuar e lexuar vetëm në kontekstin e interesave të palëve në konflikt, pasi asnjëra prej tyre nuk i përdori mandatet parlamentare për të indur ndonjë reformë në legjislacionin e partive apo për masa më të efektive ndaj korrupsionit dhe dekriminalizimit.
- Më 20 dhjetor aktiviteti i SPAK u përgëzua nga ambasadorja e SHBA-ve Yuri Kim, sukseset e fundit të SPAK sipas saj e bëjnë 2021 vitin e kthesës në luftën ndaj dekriminalizimit dhe korrupsionit. Kjo tregon që nisma e SPAK gëzon mbështetjen e plotë të përfaqësive të huaja në Shqipëri madje inkurajohet nga ata për të vazhduar aktivitetin e tyre, sepse fill pas kësaj deklarate më datë 21 dhjetor në Bashkinë Kurbin, SPAK arreston 6 zyrtarë për abuzim me tenderat.